



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. ~~1897~~..... Prot.

Vlorë, më 09/06/2022

**VENDIM**

**“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori, subjekti “Fatos Qani Likaj” me ID H31018057J, me banim në Patos, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.**

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.109, me Nr.3204/1 Prot., datë 21/10/2021, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 26.347 (njëzetegjashtë mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekë, për deklaratën doganore IMP- 4 me numër R 13411, datë 09/12/2019, ndaj subjektit debitor “Fatos Likaj” me ID H31018057J, me banim në Patos (Lagjja “Naftëtari”, Ndërtesa 64). Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Fatos Likaj” p.f, me anë të Shërbimit Postar, si dhe me anë të lajmërimit public.

Personi fizik debitor “Fatos Likaj”, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 109, me Nr.3204/1 Prot., datë 21/10/2021, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor. Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr. 109, me Nr.3204/1 Prot., datë 21/10/2021, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Fatos Likaj”, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *“Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”*,

**VENDOSA:**

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit fizik - “Fatos Likaj”, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit fizik - “Fatos Likaj”, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi fizik - “Fatos Likaj”, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 26.347 (Njëzetegjashtëmijë e treqindedyzeteshtatë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr.109, me Nr.3204/1 Prot., datë 21/10/2021, të Degës së Doganës Vlorë, si dhe kamatë vonesën e lindur.

**KRYETAR**

**Artan Bedinaj**

